

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS**

**BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



**Programi mësimor**

**GJUHË SHQIPE**

**për klasën IX**

**Shkup, 2026**

## TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

<b>Lënda mësimore</b>	<b>Gjuhë shqipe</b>
<b>Lloji/kategoria e lëndës mësimore</b>	E detyrueshme
<b>Klasa</b>	IX (e nëntë)
<b>Temat/fushat e programit mësimor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjuhë dhe komunikim</li> <li>• Letërsi, të shprehurit dhe krijimtari</li> <li>• Njohuri mediatike</li> </ul>
<b>Numri i orëve mësimore</b>	4 orë në javë / 144 orë në vit
<b>Pajisjet dhe mjetet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisjet teknike në klasë: tabelë elektronike, tabelë e shkollës, teknologji kompjuterike, printer.</li> <li>• Mjetet dhe burimet për të mësuar: fotografi, ilustrime me figura që kanë të bëjnë me përmbajtjet dhe veprimtaritë, plakate, afishe letrare, skema dhe paraqitje të ndryshme nga materiali mësimor, panele që ndjekin materialin sipas fushave programore; fjalorë, fjalorë drejtshkrimor, leksikon, enciklopedi, libra, programe/software edukative, regjistrime të rrëfimeve, regjistrime audio-vizuale;</li> <li>• Bibliotekë me libra në klasë, bibliotekë e shkollës, bibliotekë mediatike.</li> </ul> <p>Shënim: Nëse mësimi realizohet në kabinet, rekomandohet organizim i një këndi të dramës, një këndi artistiko-letrar, një këndi për gazetari, një vendi të përshtatshëm për bibliotekë në klasë.</p>
<b>Normativi për kuadrin mësimor</b>	<p>Mësimdhënjen e lëndë së gjuhës shqipe në klasën IX të arsimit fillor nëntëvjeçar mund ta realizojë personi që ka kryer drejtimin arsimor të programit studimor:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi</li> </ul>

## NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxëniet të dhëna në programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën:

### Njohuri gjuhësore

<i>Nxënësi/nxënësjë di dhe mund:</i>	
I-A.1	t'i shprehë dhe t'i transmetojë mendimet, ndjenjat, informacionin dhe qëndrimet e veta në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e vet amtare, nëpërmjet medimeve të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;
I-A.2	t'i njohë e t'i shfrytëzojë format e ndryshme të shprehjes me shkrim: ato letrare (vjersha, tregimi i shkurtër, prezantimi / të folurit, eseja (sprova) letrare, ditari etj.) dhe ato joletare (eseja tematike, njoftimi, kërkesa, komunikata, reklama etj.);
I-A.3	të zhvillojë dialog kritik e konstruktiv duke i paraqitur qëndrimet e veta në mënyrë të argumentuar;
I-A.4	të përdorë gjuhën standarde duke iu përmbajtur rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim;
I-A.6	të identifikojë veçoritë themelore të gjuhës amtare (alfabetin, historinë, dialektet etj.), si dhe ngjashmëritë e dallimet e saj me gjuhët e tjera;
I-A.7	të identifikojë autorët dhe veprat më të rëndësishme të letërsisë në gjuhën amtare;
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve dëgjimore: të jetë në gjendje t'i shkëpusë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë informacionet nga mesazhet dhe t'i shprehë ato (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë i aftë të veçojë, të analizojë, të vlerësojë dhe të përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.10	t'i kuptojë përmbajtjet e paraqitura vizualisht (diagrame, tabela e grafikë, ilustrime, filma vizatimorë etj.): të jetë në gjendje t'i ndajë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë përmbajtjet e shfaqura vizualisht dhe t'i sqarojë ato (me shkrim dhe me gojë);
I-A.11	t'i identifikojë e t'i analizojë mesazhet dhe elementet stilistike e estetike të veprave letrare;
I-A.12	të shfrytëzojë informacione nga burime dhe medie të ndryshme dhe t'u qaset atyre në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacioneve të paraqitura.
<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	nëpërmjet mësimin të gjuhës amtare zhvillohet identiteti i vet gjuhësor e kulturor, ndërsa nëpërmjet komunikimit gjuhësor përcillet trashëgimia kulturore dhe kultura e të jetuarit;
I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste e mjedise të ndryshme dhe në forma të ndryshme mundësohet komunikimi dhe ndërveprimi efikas (gjithmonë duke pasur parasysh se me kë bëhet komunikimi);
I-B.3	gjatë leximit të teksteve me përmbajtje dhe me strukturë të ndryshme, zhvillohet shkrim-leximi, formohet një këndvështrim më i gjerë për veten dhe për botën dhe kështu nxitet të shkruarit nga domosdoshmëria dhe me kënaqësi;
I-B.4	përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit personal mund të kontribuojë për të mbajtur e për të përmirësuar komunikimin, por edhe të shkaktojnë mosmarrëveshje e konflikte;
I-B.5	leximi dhe të shprehurit në gjuhën amtare janë të rëndësishme për zhvillimin dhe nxitjen e krijimtarsisë dhe të të menduarit kritik;
I-B.6	njohja e gjuhës amtare është baza e të mësuarit dhe përvetësimit të njohurive në të gjitha fushat e tjera (lëndët mësimore);
I-B.7	njohja e gjuhës amtare është një ndër shtyllat më të rëndësishme të identitetit etnik.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të këtyre fushave të Standardeve nacionale: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike, Teknikë, teknologji dhe sipërmarrje dhe Të shprehurit artistik dhe kulturë.**

#### IV. Njohuri digjitale

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
IV-A.1	të hulumtojë dhe krahasojë mundësitë e pajisjeve digjitale të njohura dhe të reja dhe të vlerësojë, të përzgjedhë dhe të përdorë në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë dhe një situatë konkrete;
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase, të zgjedhë dhe të instalojë programet që i nevojiten, të përdorë programe mbrojtëse dhe të zgjidh problemet rutinë për funksionimin e pajisjeve dhe rrjeteve digjitale;
IV-A.3	të përdorë mënyra të ndryshme të organizimit, të ruajtjes së sigurt dhe të shpërndarjes së përmbajtjeve në pajisje dhe në rrjete të ndryshme në hapësirën digjitale;
IV-A.4	në bashkëpunim me të tjerët, të analizojë një problem, të zhvillojë ide dhe plan për hulumtimin dhe zgjidhjen e tij dhe të planifikojë kur dhe për çfarë do të përdorë TIK-un.
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale dhe të vlerësojë rëndësinë e tyre në raport me kërkesën konkrete dhe besueshmërinë e burimit;
IV-A.6	të zgjedhë dhe të përdorë mjete të ndryshme për përpunimin e të dhënave, t'i analizojë të dhënat dhe t'i prezantojë ato në mënyra të ndryshme duke i respektuar rregullat e përdorimit;
IV-A.7	të zgjedhë e të përdorë mjetet adekuate të TIK-ut për komunikim, të këmbëjë informacione në mënyrë të sigurt, të kontaktojë e të bashkëpunojnë me të tjerët në projekte online, në veprimtari sociale ose për nevojat e veta;
IV-A.8	t'i shfrytëzojë në mënyrë të sigurt e me përgjegjësi përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore e sociale dhe format digjitale;
IV-A.9	në komunikimin me të tjerët, në hapësirën digjitale multikulturore, i respekton pjesëmarrësit e ndryshëm dhe ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike të sjelljes në hapësirën dixhitale;
IV-A.10	të kujdeset për identitetin, sigurinë dhe reputacionin e vet digjital dhe t'i përfillë politikat rreth privatësisë.
I-A.12	të hulumtojë mundësitë për përdorimin e modeleve dhe simulimeve të ndryshme, kombinimin e paraqitjes statike dhe dinamike, zë, tekst dhe imazhe për të modifikuar ose për të krijuar përmbajtje të thjeshta multimediale krijuese me një qëllim të caktuar dhe për një audiencë specifike;
IV-A.13	të përcaktojë kriteret për cilësinë e përmbajtjeve dhe zgjidhjeve digjitale, duke përfshirë risitë dhe përdorshmërinë e tyre.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme - ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
IV-B.2	përdorimi i papërgjegjshëm dhe i papërshtatshëm i TIK-ut ka kufuzime dhe mund të sjellë rreziqe për individin ose shoqërinë;
IV-B.3	potencialet e TIK-ut vazhdimisht rriten prandaj duhet të ndiqen dhe të përdoren, por gjithashtu duhet të ketë qëndrim kritik ndaj vërtetësisë, besueshmërisë dhe ndikimit të të dhënave dhe informacionit të disponueshëm përmes pajisjeve digjitale;
IV-B.4	në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, e privatësisë dhe e sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes e dhuna kibernetike dhe të përfillen rregullat e normat e komunikimit në komunitetet digjitale;
IV-B.5	informacionet e disponueshme në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve;

IV-B.6	duhet të respektohen të drejtat e pronësisë intelektuale të përmbajtjeve të disponueshme në rrjetet dixhitale.
--------	--

## V. Zhvillim personal dhe social

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
V-A.2	të zgjedhë dhe të praktikojë aktivitete që sigurojnë zhvillimin dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tij/saj mendore dhe fizike;
V-A.3	të identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të vet, i cili ndërtohet mbi bazën e përkatësisë së grupeve të ndryshme shoqërore (për shembull, identiteti gjinor, etnik dhe kombëtar) dhe rolet e ndryshme që ka në jetë (për shembull, nxënësi, djali/vajza) ;
V-A.4	të bëjë vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë anët e fuqishme dhe anët e dobëta) dhe mbi këtë bazë t'i përcaktojë përparësitë që do t'ia mundësojnë atij/asaj të zhvillohet e të përparojë;
V-A.5	të njohë emocionet e vetvetja dhe të tjerët, t'i kuptojë pasojat nga reagimet e veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji përkatëse për t'u përballur me emocionet;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimin e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.8	të organizojë kohën në atë mënyrë që t'i mundësojë atij/asaj, në mënyrë efikase dhe efektive të arrijë qëllimet e përcaktuara dhe të kënaqë nevojat e veta;
V-A.9	të parashikojë pasojat e veprimeve të veta dhe të veprimeve të tjerëve për veten dhe për të tjerët;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.18	të hulumtojë duke bërë pyetje përkatëse për të zbuluar problemet, të analizojë dhe të vlerësojë informatat, sugjerimet dhe të verifikojë supozimet;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
V-A.21	të analizojë, të vlerësojë dhe të përmisojë të nxënit.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
V-B.1	kujdesi për trupin dhe praktikimi i rregullt i aktiviteteve fizike është kusht i rëndësishëm për të siguruar shëndet të mirë fizik dhe mendor;
V-B.2	njohja e identitetit personal kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimin e personalitetit;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerret është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;

V-B.6	suksesi në jetë varet kryesisht nga qëllimet që ai i vendos vetes, ndërsa efikasiteti dhe efektiviteti në arritjen e qëllimeve të vendosura varet kryesisht nga mënyra se si ai/ajo i planifikon aktivitetet e tij/saj dhe se si e organizon kohën;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.
V-B.10	të mësuarit është proces i vazhdueshëm që nuk përfundon në shkollë dhe nuk kufizohet vetëm në arsimin formal.

## VI. Shoqëri dhe kulturë demokratike

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
VI-A.3	t'i formulojë e t'i argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë me vëmendje e t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të sillet me respekt ndaj tyre, madje edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror, orientim seksual, etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjytimeve të vetja e të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VI-A.8	të kuptojë se çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, të gjejë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
VI-A.9	të njohë grupet e pambrojtura (vulnerabël) në shoqëri të marrë pjesë në to dhe të mbështesë veprime humanitare dhe vullnetare;
VI-A.17	të analizojë ndikimin e mediave të shkruara, elektronike dhe sociale në opinionin publik dhe të zgjedhë burime të besueshme informacioni mbi të cilat do t'i bazojë pikëpamjet e veta;
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VI-B.1	nuk duhet të diskriminojë njerëzit në bazë të dallimeve (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi ndryshe, status social, orientimi seksual, etj.);
VI-B.2	të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;
VI-B.5	barazia dhe kohezioni social janë të nevojshme për funksionimin e suksesshëm të komunitetit;
VI-B.6	angazhimi personal dhe bashkëpunimi me të tjerët janë çështje thelbësore për realizimin e interesit të përbashkët publik.

## VII. Teknikë, teknologji dhe sipërmarrje

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
VII-A.2	të shpjegojë nevojën për inovacion për zhvillimin e shoqërisë;
VII-A.4	të gjenerojë ide dhe të krijojë aktivitete që çojnë në prodhim dhe/ose në shërbime;
VII-A.9	të marrë pjesë aktive në punën e ekipit sipas rregullave të miratuara paraprakisht dhe duke respektuar denjësisht rolin dhe ndihmesën e të gjithë anëtarëve të ekipit;

<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VII-B.3	Iniciativa për bërë diçka është kushti thelbësor për të bërë ndryshime në jetën personale dhe jetën në komunitet, dhe suksesi i ndryshimeve lidhet me përballimin e sfidave dhe/ose marrjen e rreziqeve;
VII-B.4	etika e punës, ndjeshmëria kulturore dhe sjellja ndaj të tjerëve janë të rëndësishme për krijimin dhe ruajtjen e një klime pozitive pune;
VII-B.5	burimet nuk janë të pakufizuara dhe duhet të përdoren me përgjegjësi.

## VII. Të shprehurit artistik dhe kulturë

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.2	të identifikojë manifestimet e ndryshme të kulturës popullore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e vlerave estetike;
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore;
VIII-A.6	të identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e ngushtë e të gjerë dhe të analizojë lidhjet dhe ndërvarësitë reciproke të tyre;
VIII-A.7	të njohë dhe të shpjegojë se si aspektet kulturore ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në kontekste të ndryshme;
VIII-A.8	të njohë rëndësinë dhe të shpjegojë përfitimet dhe sfidat e globalizimit dhe lidhjen e çështjeve lokale me lëvizjet globale;
VIII-A.9	të njohë dhe të shpjegojë se si kultura së cilës i përket (përfshirë traditën dhe fenë) ka ndikuar në formimin e identitetit dhe botëkuptimit të tij/saj;
VIII-A.10	të identifikojë dhe të shqyrojë stereotipet dhe paragjykimet ndaj anëtarëve të grupeve të tjera kulturore që shfaqen në mjedisin e tij/saj.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VIII-B.3	respektimi dhe promovimi i kulturës së vet kontribuon në forcimin e identitetit dhe dinjitetit kulturor;
VIII-B.5	dallimet ndërmjet kulturave duhet të shihen si mundësi për të mësuar dhe si sfidë për mirëkuptim dhe përparim të ndërsjellë;
VIII-B.6	respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon që edhe kultura e vet të respektohet nga të tjerët.

## REZULTATET E TË NXËNIT

Fusha programore: **GJUHË DHE KOMUNIKIM**

Gjithsej: 67 orë

### Rezultatet e të nxënit:

*Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:*

1. të shpjegojë rrethanat shoqërore dhe kulturore në të cilat përdoret gjuha shqipe në shekullin XX;
2. të përmendë, të analizojë dhe të diskutojë (të mbështetura me citime) qëndrimet dhe aktivitetet e delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit të shkruara në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe;
3. të shpjegojë dallimet kryesore mes gjuhës letrare dhe dialekteve.
4. të shpjegojë marrëdhëniet e pjesëve të fjalisë në një fjali të përbërë me nënrenditje dhe të sqarojë përdorimin e presjes në të;
5. të kuptojë dhe të shpjegojë funksionin e gjymtyrëve homogjene në fjali duke përdorur edhe rendin e drejtë të fjalëve në fjali;
6. të dallojë njësitë frazeologjike dhe kuptimet e figurshme të tyre;
7. të përmendë llojet e fjalorëve dhe fjalorët e gjuhës standarde shqipe;
8. të lexojë me të kuptuar tekste nga stile të ndryshme funksionale dhe të përmbledhë përmbajtjen e tyre;
9. të lexojë me të kuptuar tekste më të ndërlikuara dhe më të gjata dhe të interpretojë përmbajtjen e tyre;
10. të shpjegojë dhe të respektojë rregullat e drejtshkrimit.

*Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:*

1. përdorimi i gjuhës në kontekste dhe mjedise të ndryshme, si dhe në forma të ndryshme, mundëson komunikim dhe ndërveprim efikas;
2. njohja e gjuhës shqipe është themel i të nxënit dhe i përvetësimit të njohurive nga të gjitha fushat e tjera.

### Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):

#### Shkenca për gjuhën

- **Gjuha shqipe midis gjuhëve ballkanike**  
(karakteristikat e bashkësisë gjuhësore ballkanike: nyja e prapavendosur tek emri, rimarrja e kundrinorit, humbja e paskajores (infinitivit), ndërtimi i kohës së ardhme me “do të” (dua të), eptimi sintetik dhe analitik etj.

### Standardet e vlerësimit:

- Përmend dhe shpjegon veçoritë specifike të gjuhës shqipe si rezultat i proceseve të ndërsjella ndërmjet gjuhëve ballkanike.
- Harton shembuj me veçoritë specifike të gjuhës shqipe.

## Historia e gjuhës shqipe

- **Gjuha shqipe në shekullin XX**  
(pikëpamjet e Androkli Kostallarit, Mahir Domit, Eqrem Çabejit, Idriz Ajetit, Dhimitër Shuteriqit, Rexhep Qoses, Shaban Demirajt etj. për gjuhën letrare shqipe; tekstet shkencore; zhvillimi historik i gjuhës; bazat dialektore të toskërishtes dhe gegërishtes mbi të cilat është formuar shqipja standarde; parimet e drejtshkrimit (fonetikmorfologjik, historik-tradicional, simbolik; leksiku i shqipes standarde nga të folmet dialektore shqipe)
- **Gjuha letrare dhe dialektet e gjuhës shqipe**  
(gegërishtja, toskërishtja, nëndialektet, shtrirja gjeografike e dialekteve)
- **Gjuha shqipe midis dy luftërave botërore**  
(politika asimiluese, ndalimi i përdorimit të gjuhës shqipe në Maqedoni, Abetaret, skena teatrore shqipe, drama, romane dhe poezi të shkruara në gjuhën shqipe në shekullin XX;)
- **Kodifikimi i gjuhës standarde shqipe**  
(kodifikimi i gjuhës standarde, ngjarje historike të lidhura me kodifikimin e gjuhës shqipe, alfabeti i gjuhës shqipe (1908), drejtshkrimi ë gjuhës shqipe (1972), zyrtarizimi i gjuhës shqipe (1912), Drejtshkrimi i gjuhës shqipe; Fjalori drejtshkrimor; Fjalori i gjuhës së sotme shqipe; Gramatika e gjuhës letrare shqipe etj.)

- Komenton dhe interpreton qëndrimet e delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit të shkruara në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.
- Përmend dhe arsyeton fakte për rëndësinë dhe rolin e Androkli Kostallarit, Mahir Domit, Eqrem Çabejit, Idriz Ajetit, Dhimitër Shuteriqit, Rexhep Qoses, Shaban Demirajt etj. në kodifikimin e gjuhës shqipe.
- Njeh shtrirjen gjeografike të dialekteve të gjuhës shqipe.
- Shpjegon dallimet kryesore mes gjuhës letrare dhe dialekteve.
- Përmend faktet historike për ndarjen territoriale të shqiptarëve në trojet autoktone dhe për çështjen gjuhësore në periudhën midis dy luftërave botërore.
- Shpjegon aktivitetet e intelektualëve shqiptarë dhe përpjekjet e tyre për zhvillimin e gjuhës shqipe.
- Shpjegon rëndësinë e shkrimtarëve shqiptarë dhe të veprave të tyre në zhvillimin e gjuhës shqipe të shekullit XX.
- Shpjegon nocionin e kodifikimit (normëzimit) të gjuhës standarde shqipe.
- Përmend ngjarjet historike dhe datat që lidhen me kodifikimin e gjuhës standarde shqipe.

## Morfologjia

- **Analiza morfologjike e fjalisë**  
(klasifikimi morfologjik – ndarja e fjalëve sipas ndryshueshmërisë/pandryshueshmërisë; fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme: emra, përemra, mbiemra, folje, numërorë; ndajfolje, parafjalë, lidhëza, pjesëza, fjalë modale, pasthirrma)
- **Morfosintaksë**  
(funksionet e emrave, mbiemrave, përemrave foljeve, dhe ndajfoljeve në fjali)

- Bën analizë morfologjike të fjalisë.
- Identifikon funksionet e emrave, mbiemrave, përemrave, foljeve dhe ndajfoljeve në fjali.

<p><b>Sintaksë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përshtatja e kryefjalës dhe kallëzuesit</b> (përshtatja sipas gjinisë, numrit dhe vetës)</li> <li>• <b>Gjymtyrët homogjene</b> (kryefjalë e kallëzues homogjenë, përcaktorë, kundrinorë, rrethatorë homogjenë etj.)</li> <li>• <b>Fjalja e përbërë (periudha) me nënrenditje</b> (fjalja kryesore, fjalja e varur; fjali të nënrenditura: kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore, përcaktore, rrethatore (vendore, kohore, mënyrore, sasiore, shkakore, qëllimore, rrjedhimore, kushtore, lejore dhe krahasore); lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore në fjalitë e përbëra me nënrenditje)</li> <li>• <b>Rendi i fjalëve në fjali</b> (rendi i zakonshëm, rendi i anasjelltë (i përmbysur))</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton kryefjalën në fjali dhe shpjegon se çfarë mund të emërtojë ajo.</li> <li>• Rendit fjalët që mund të paraqiten në funksion të kryefjalës në fjali.</li> <li>• Kupton lidhjen e ndërsjellë ndërmjet kryefjalës dhe kallëzuesit dhe përshtatjen e tyre sipas vetës, gjinisë dhe numrit.</li> <li>• Kupton funksionin e gjymtyrëve homogjene në fjali (kryefjalë e kallëzues homogjenë, përcaktorë, kundrinorë, rrethatorë homogjenë etj.)</li> <li>• Identifikon dhe dallon kuptimet e llojeve të fjalive të përbëra (periudhave) me nënrenditje.</li> <li>• Përdor drejt lidhëzat dhe i dallon sipas marrëdhënies së nënrenditjes që vendosin ndërmjet pjesëve të fjalisë së përbërë (periudhës).</li> <li>• Ndërton lloje të ndryshme fjalish të përbëra me nënrenditje, duke përdorur drejt lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore në kontekste të ndryshme, si dhe përdor drejt presjen në fjali.</li> <li>• Përdor drejt lidhëzat e përbëra dhe lokucionet lidhëzore në fjalitë e përbëra me nënrenditje</li> <li>• Bën analizë sintaksore të fjalive të përbëra (periudhave).</li> <li>• Përdor rendin e drejtë të fjalëve në fjali.</li> </ul>
<p><b>Leksikologjia</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Frazeologjizmat</b> (njësitë frazeologjike, kuptimi i drejtpërdrejtë, kuptimi i figurshëm)</li> </ul> <p><b>Leksikografia</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Fjalori, llojet bazë të fjalorëve</b> (leksikon, vokabular; fjalor: enciklopedik, gjuhësor, njëgjuhësh, shumëgjuhësh, fjalor të fjalëve dhe shprehjeve të huaja, fjalor shpjegues, fjalor drejtshkrimor, <i>Fjalori i Frang Bardhit (1635)</i>; <i>Fjalori i Konstanti Kristoforidhit (1904)</i>; <i>Fjalori i shoqërisë "Bashkimi" (1909)</i>; <i>Fjalori i Nikollë Gazulli (1941)</i>; <i>Fjalori i gjuhës shqipe (1954)</i>; <i>Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe (1976)</i>; <i>Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980)</i>; <i>Fjalori Enciklopedik i Shqipes (1985)</i>; <i>Fjalori i shqipes së sotme (2002)</i>; <i>Fjalori Enciklopedik i Shqipes elektronik (2008)</i>; <i>Fjalori elektronik – fjalori.online (2026)</i> etj.)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon se njëstë frazeologjike kanë kuptimin të figurshëm dhe jo të drejtpërdrejtë të fjalëve.</li> <li>• Njeh llojet e ndryshme të fjalorëve në varësi të qëllimit dhe materialit gjuhësor që përpunojnë.</li> <li>• Shpjegon dallimin midis një fjalori dygjuhësh dhe një fjalori të fjalëve dhe shprehjeve të huaja.</li> <li>• Rendit fjalorët gjuhësorë që përdoren në jetën e përditshme.</li> </ul>

<p><b>Stilistika e gjuhës (Linguostilistika)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Stilet ligjërimore</b> (ligjërimi i folur dhe ligjërimi i shkruar: ligjërimi i shkujdesur, bisedor dhe libror)</li> <li>• <b>Stilet funksionale</b> (shkencor, shtetëror-administrativ, politiko-shoqëror, i letërsisë artistike, fetar; publicistika)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon llojet e ligjërimeve.</li> <li>• Njeh dhe i rendit veçoritë e stileve funksionale në komunikim me gojë dhe me shkrim.</li> </ul>
<p><b>Rregullat e drejtshkrimit dhe shenjat e pikësimit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Shkurtesat (akronimet) dhe shkurtimeve e fjalëve</b> (listë shkurtesash (akronimesh) në gjuhën shqipe; lista e shkurtimeve më të zakonshme)</li> <li>• <b>Shqiptimi dhe të shkruarit drejt i fjalëve me prejardhje të huaj</b></li> <li>• <b>Rregullat e shkrimit të fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes</b></li> <li>• <b>Të shkruarit drejt të datave.</b></li> <li>• <b>Presja në fjalitë e përbëra me nënrenditje</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbaton rregullat për shënimin e shkurtesave (akronimeve) (ShBA, MASH, OKB) dhe të shkurtimeve të fjalëve (etj.; d.m.th.; p.sh.; f.; prof.); (kg, cm, w, Cl, Mn).</li> <li>• Shkruan dhe shqipton drejt fjalët me prejardhje të huaj.</li> <li>• Shjeron dhe shkruan drejt fjalët njësh, ndaras dhe me vizë në mes.</li> <li>• Shpjegon dhe shkruan drejt datat.</li> <li>• Përdor drejt presjen gjatë shkrimit të një fjalisë të thjeshtë (kur numëron gjëra, kur bën plotësim të mendimit, kur thekson dhe veçon diçka brenda fjalisë).</li> <li>• Përdor drejt presjen në fjalitë e përbëra (periudhat) me nënrenditje.</li> </ul>
<p><b>Të lexuarit me të kuptuar</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të lexuarit me të kuptuar i teksteve më të ndërlikuara dhe më të gjata</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon fjalë ose fraza të panjohura në një tekst të dhënë bazuar në përdorimin e tyre në kontekst të caktuar.</li> <li>• Nxjerr fjalët kyçe nga teksti i lexuar dhe mbi bazën e tyre përmbledh tekstin.</li> <li>• Krahason fakte/opinione midis dy teksteve bazuar në një karakteristikë të përbashkët në to.</li> <li>• Përcakton dallimin midis përmbajtjes dhe qëllimit, si dhe midis fakteve dhe opinionit që lidhen me deklaratat të ndërlikuara/abstrakte në tekst.</li> <li>• Përdor citate, shembuj ose detaje si dëshmi për të mbështetur përfundimet që nxjerr lidhur me tekstin e lexuar.</li> <li>• Zbërthen përfundime lidhur me besueshmërinë e informacionit ose të përfundimeve të dhëna në një pjesë të tekstit.</li> </ul>

- Integron informacion nga disa lloje teksti për të identifikuar idenë kryesore ose për të kuptuar kuptimin e një fjale/fraze.
- Lidh përmbajtjen e tekstit me njohuritë e mëparshme, me përvojën personale dhe me qëndrimet e veta.

### Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):

*(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)*

- Nxënësit ndahen në grupe. Çdo grup merr disa ngjitëse/stikera me shembuj të veçorive të gjuhës shqipe që e dallojnë atë nga gjuhët e tjera ballkanike. Në tabelë janë radhitur veçoritë dhe nxënësit, duke lexuar shembujt që kanë në ngjitëse/stikera, përcaktojnë se për cilën veçori bëhet fjalë. Ata shpjegojnë dhe japin shembuj të tyre. Shembujt e rinj vendosen në një poster të përbashkët që shërben si përkujtues për veçoritë dalluese të gjuhës shqipe nga gjuhët e tjera ballkanike.
- Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grup merr një fletë pune me pjesë të Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe pyetje që lidhen me këtë pjesë, të cilat duhet t'i përgjigjen. Pas leximit dhe diskutimit në grup, nxënësit përgjigjen në pyetjet e fletës së punës: *1. Kur dhe ku u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit? 2. Mbi ç'bazë dialektore është ndërtuar shqipja standarde? 3. Mbi cilat parime është mbështetur shqipja standarde? 4. Si duhet të zgjidhen problemet e veçanta të drejtshkrimit? 5. Si duhet të shkruhen fjalët dhe emrat me prejardhje të huaj? 6. Pse duhet të shkruhen fjalët bashkë ose ndaras ose me vizë në mes? 7. Cili është kriteri i përdorimit të shkronjave të mëdha? 8. Numëro delegatët e Kongresit të Drejtshkrimit.* Pas plotësimit të fletës së punës, çdo grup prezanton përgjigjet.
- Nxënësit ndjekin një prezantim të përgatitur nga mësimdhënësi/-ja mbi gjendjen e gjuhës shqipe midis dy luftërave botërore, si dhe mbi aktivitetet e intelektualëve shqiptarë në atë periudhë dhe përpjekjet e tyre për zgjidhjen e çështjes gjuhësore shqipe. Pastaj punojnë në grupe. Çdo grup merr një tekst të ndryshëm nga një autor i caktuar, për shembull (Faik Konica, Fan Noli, Ndre Mjeda që kanë shkruar në toskërishten letrare) dhe (Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Martin Camaj që kanë shkruar në gegërishten letrare) etj., me detyrë ta lexojnë tekstin, të diskutojnë për përmbajtjen e tij dhe për dialektin në të cilin është shkruar. Përmes diskutimit zbulohet se autorët shqiptarë midis dy luftërave botërore në veprat e tyre përdornin dialektet e shqipes (toskërishten letrare dhe gegërishten letrare) dhe kështu luajtën një rol të rëndësishëm në konsolidimin gjuhës letrare (standarde) shqipe.
- Nxënësit ndahen në disa grupe. Marrin udhëzime se do të zhvillojnë një garë-kuiz, por çdo grup duhet të përgatisë disa pyetje që lidhen me kodifikimin e gjuhës letrare shqipe, si dhe ngjarjet historike të lidhura me kodifikimin dhe personalitetet e rëndësishëm që kontribuan në zhvillimin e gjuhës shqipe bashkëkohore gjatë dhe pas kodifikimit. Për shembull, një grup shkruan pyetje për Eqrem Çabejin, tjetri për Androkli Kostallarin, tjetri për Idriz Ajetin, tjetri për Shaban Demirajn, tjetri për Rexhep Qosen, tjetri për nocionin e kodifikimit, tjetri për ngjarjet historike dhe datat e kodifikimit të gjuhës letrare shqipe, tjetri për alfabetin dhe drejtshkrimin etj. Çdo grup shkruan një pyetje në një fletë. Më pas formohet një komision prej 3-4 nxënësish, i cili do të monitorojë saktësinë e përgjigjeve gjatë lojës. Nxënësit e tjerë ndahen në grupe konkurruese. Një nxënës nga komisioni shpërndan pyetjet midis grupeve konkurruese, pra secili grup merr nga një pyetje. Loja zhvillohet në tre runde (ose më shumë, në varësi të kohës). Fitues është grupi që ka më shumë përgjigje të sakta.

- Nxënësve u jepet një fletë mësimore që përmban disa fjali. Në të është treguar sa fjalë ka nga secila kategori: folje, emra, përemra, lidhëza etj. Me lapsa ngjyrash të ndryshme ata duhet të nënvizojnë fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme, pastaj t'i vendosin në një tabelë në kolonat përkatëse sipas grupit të fjalëve. Diskutohet mënyra se si i kanë ndarë fjalët dhe çfarë i ndan/dallon dy grupet e fjalëve. Përfundimet e diskutimit shkruhen si kujtesë /përkujtes.
- Nxënësit ndahen në dy grupe. Ata rreshtohen dhe grup pas grupi nxjerrin fjalë nga një enë e madhe. Çdo fjalë duhet të vendoset në enën ku është shkruar grupi i fjalëve ku i përket. Kur mbaron koha, enët hapen dhe numërohen sa fjalë janë vendosur saktë. Çdo fjalë e saktë fiton pikë. Ndahen gabimet dhe bëhet një diskutim mbi llojet e fjalëve dhe ndryshueshmërinë ose pandryshueshmërinë e tyre.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merr një pjesë të fjalisë që duhet ta plotësojë me shembuj të vet, pra me një fjali të nënrenditur. Çdo grup prezanton punën e bërë dhe diskutohet për saktësinë e saj.
- Në tabelë janë të varura në fletë lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore që përdoren për të formuar fjalitë e përbëra me nënrenditje. Nxënësit, në mënyrë vullnetare, marrin një fletë dhe krijojnë një fjali ku përdorin lidhëzat e shkruara në fletë. Të tjerët kontrollojnë nëse fjalia është gramatikisht e saktë.
- Nxënësit marrin një listë me fjali ku disa prej tyre përmbajnë gjymtyrë homogjene dhe disa jo, (p.sh. *Nxënësi është i sjellshëm, i zgjuar dhe i përpiktë; Ai bleu një libër të ri; Në park luanin djem dhe vajza; Ai veshi një pallto të trashë dimri; Në obor kishte lule të kuqe dhe të bardha etj.*). Në drasë, në dy kolona nxënësit ndajnë fjalitë me gjymtyrë homogjene dhe fjalitë me gjymtyrë jo homogjene. Me pas diskutojnë dallimet mes tyre.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merr disa fletëza të vogla ku në çdo fletë shkruan nga një fjalë (kryefjalë, kallëzues dhe gjymtyrë të tjera të fjalisë). Grupet kanë për detyrë të bashkojnë fjalët/gjymtyrët për të krijuar një fjali kuptimplotë me renditje të duhur të fjalëve. Grupet prezantojnë fjalitë e krijuara dhe bashkë diskutojnë për gabimet eventuale.
- Nxënësit të ndarë në grupe, marrin nga dy lloje fletash, disa me njësi frazeologjike dhe disa me kuptimin e figurshëm të tyre (p.sh: *Mbaj vesh/Dëgjoj me kujdes; I ra pika/U turpërua shumë; I iku truri/U çmend etj.*). Nxënësit duhet të gjejnë çiftin e saktë, pra, shprehjen me kuptimin. Grupi që lidh më shpejt dhe saktë, shpallet fitues.
- Nxënësit vizitojnë bibliotekën e shkollës ose bibliotekën në vendin ku jetojnë. Ata kanë mundësinë të shqyrtojnë fjalorët dhe të bëjnë një krahasim midis tyre. Secili shkruan shënime për atë që ka vërejtur. Diskutojnë për llojet e fjalorëve dhe qëllimin e tyre dhe në fund shkruajnë një përfundim të përbashkët mbi ndarjen e fjalorëve.
- Mësimdhënësi/-ja sjell në klasë: *Fjalor shpjegues të gjuhës shqipe, Fjalor enciklopedik të gjuhës shqipe, Fjalor antonimik, Fjalor drejtshkrimor të gjuhës shqipe, Fjalor terminologjik, Fjalor shqip-anglisht, Fjalor shqip-anglisht-gjermanisht* etj. Nxënësit ndahen në grupe dhe me teknikën “rrotullues” të gjithë fjalorët kalojnë nëpër duart e nxënësve. Detyra e tyre është të vëzhgojnë dhe të shkruajnë çfarë gjenden të përbashkëta dhe çfarë ndryshon midis tyre. Pastaj secili grup kërkon një njësi gjuhësore nga secili fjalor. Punimi prezantohet para gjithë klasës.
- Gjatë orës, mësimdhënësi/-ja hap faqet e internetit: <https://fjalori.online/>;  
<https://www.klasalettersi.com/wpcontent/uploads/2017/03/Drejtshrimi-i-gjuh%C3%ABs-shqipe-1973.pdf>;

<https://gjuhashqipe.com/softueret/drejtshkrimori>; <https://fjalorthi.com/>; <https://fjale.al/>; etj., ua prezanton dhe ua demonstroi nxënësve përdorimin e tyre. Nxënësit përpunon nga tabletët në shkollë të lidhen dhe të kërkojnë në fjalorë. Hapet një diskutim mbi mundësitë e këtyre fjalorëve online dhe funksionalitetin e tyre në krahasim me fjalorët në formë të shtypur.

- Nxënësit ndahen në pesë grupe, secili grup merr një tekst me stil funksional dhe një detyrë që duhet ta shprehë atë stil. P.sh.: **Grupi: stil ligjërues** shkruan një letër nga pushimet në një kamp për fëmijë, drejtuar prindërve të tyre; **Grupi: stil i letërsisë artistike**, shkruan një poezi; **Grupi: stil politiko-shoqëror**, shkruan një fjalim për nxënësit e klasës së nëntë lidhur me aktivitetet e organizimit të gjysmëmaturës; **Grupi: stil shkencor**, shkruan një tekst të shkurtër për gjithësinë; **Grupi: stil shtetëror-administrativ**, shkruan një kërkesë drejtuar drejtorit të shkollës për të shqyrtuar idetë për festimin e gjysmëmaturës. Më pas, detyrat lexohen me zë të lartë para gjithë klasës dhe diskutohet për veçoritë e secilit stil veçmas.
- Nxënësit mësojnë rregullat për shkurtesat e emërtimeve të përbëra. Ndahen në grupe dhe në tabelë shkruhet përshembull: *Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Organizata e Kombeve të Bashkuara*. Grupet kanë 20 sekonda për të shkruar shkurtesën (akronimin) për shembull: MASH, ShBA, OKB. Më pas e paraqesin atë para klasës. Ata që e kanë shkruar saktë marrin pikë, të cilat shënohen në tabelën e përgatitur më parë në dërrasë. Për të kontrolluar nëse i zotërojnë rregullat e shkurtesave të fjalëve, mund të shkruhet edhe ndonjë emërtim i paqenë dhe të shihet se si do të formojnë prej tij një shkurtesë. Diskutohet dhe nxirren përfundime në përputhje me shembujt e paraqitur.
- Në bankë vendoset një enë në të cilën ka shkurtime të fjalëve për shembull: *etj.; d.m.th.; p.sh.; f.; prof.; kg, cm, w, Cl, Mn*. Nxënësit dalin dhe tërheqin një fletëz ku është shkruar një shkurtime i fjalës dhe në tabelë e shkruajnë emërtimin e plotë.
- Nxënësit marrin një fletë pune në të cilën janë shkruar fjali të përbëra me nënrenditje pa shenja pikësimi. Detyra është që të vendosin pikë, presje ose ndonjë shenjë tjetër që mendojnë se është e nevojshme. Më pas kontrollohen së bashku.
- Nxënësit ndahen në grupe të vogla. Secili grup merr kopje të dy teksteve me të njëjtën temë dhe një fletë pune me një tabelë të përgatitur më parë, si dhe pyetje dhe detyra që do të përdoren për të kontrolluar njohuritë e fituara mbi faktet dhe mendimet. Grupet kanë për detyrë t'i lexojnë me kujdes tekstet dhe më pas të diskutojnë shkurt për përmbajtjen e tyre. P.sh. tekstet: **“Ruajtja e Mjedisit”**

**Teksti 1:** *"Ekologjia nuk është thjesht një shkencë, por një përgjegjësi morale që po e shpërfillim çdo ditë. Është e dhimbshme të shohësh se si lakmia njerëzore po shkatërron shtëpinë tonë të përbashkët. Sipas mendimit tim, riciklimi nuk mjafton nëse nuk ndryshojmë rrënjësisht mënyrën se si konsumojmë. Ne duhet të ndihemi fajtorë për çdo plastikë që hedhim dhe të kërkojmë nga qeveritë masa më të rrepta, sepse e ardhmja e fëmijëve tanë varet nga dashuria që tregojmë sot për natyrën."*

**Teksti 2:** *"Ekologjia studion ndërveprimin e organizmave të gjallë me mjedisin e tyre rrethues. Sipas raporteve ndërkombëtare, emetimet globale të dioksidit të karbonit (CO2) janë rritur me mbi 60% që nga viti 1990. Aktualisht, rreth 8 milionë tonë plastikë përfundojnë në oqeanë çdo vit, duke dëmtuar ekosistemet detare. Shpyllëzimi kontribuon në humbjen e biodiversitetit, ku shkencëtarët vlerësojnë se miliona specie rrezikojnë zhdukjen nëse temperaturat globale rriten me më shumë se 1.5 gradë Celsius."*

Detyra e parë është që në tabelë të ndajnë faktet dhe mendimet si për njërin, ashtu edhe për tekstin tjetër. Secili grup e lexon punën e vet para gjithë klasës dhe jep shpjegime për çdo fakt ose mendim të veçantë.

- Nxënësit ndahen në grupe të vogla. Ata e lexojnë tekstin: **“Ndikimi i rrjeteve sociale në jetën e adoleshentëve”**

*“Rrjetet sociale luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme të adoleshentëve. Nga Instagram-i deri te TikTok-u, adoleshentët i përdorin këto platforma për të ndarë momente nga jeta e tyre, për t’u lidhur me miqtë dhe për të qenë në hap me trendet më të fundit. Por, a kanë këto rrjete vetëm anë pozitive? Disa studime tregojnë se përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale mund të ketë ndikim negativ në shëndetin mendor të adoleshentëve, duke përfshirë depresionin dhe ankthin. Një studim i publikuar në ‘Journal of Abnormal Child Psychology’ në vitin 2019 tregon se më shumë kohë e kaluar në rrjete sociale lidhet me shfaqjen e simptomave të depresionit te adoleshentët.”*

Nxënësit, të ndarë në grupe, vazhdojnë të diskutojnë për pyetjet në vijim: Si ju duket ndikimi i rrjeteve sociale në jetën tuaj? Cilat janë aspektet pozitive të përdorimit të rrjeteve sociale për ju? Cilat janë aspektet negative të përdorimit të rrjeteve sociale për ju? Si lidhen qëndrimet tuaja personale me përmbajtjen e tekstit? Më pas, secili grup prezanton njohuritë për temën, duke përdorur qëndrimet dhe përvojat personale të nxënësve, të cilat lidhen me përmbajtjen e tekstit që lexuan.

- Me nxënësit diskutohet se si mund të verifikohet besueshmëria e disa informacioneve në një tekst. Përfundimet nga diskutimi mësimdhënësi/-ja i shënon në tabelë. Më pas nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet një tekst i shkurtër. Nxënësit duhet ta lexojnë tekstin dhe më pas të diskutojnë për besueshmërinë e informacioneve në tekst / përfundimeve të ofruara në një pjesë të tij. Secili grup e analizon tekstin sipas përfundimeve që mësimdhënësi/-ja ka shkruar në tabelë, pastaj përgatit përfundim tjetër të tekstit sipas mendimit të vet për besueshmërinë e informacioneve ose përfundimeve të dhëna. Grup pas grupi prezantojnë dhe pas çdo prezantimi hapet diskutim për tekstin dhe për atë që u ka krijuar më shumë dyshime. Nxënësit diskutojnë dhe arsyetojnë para gjithë klasës. Shembull teksti:

*“Toka është një disk i rrafshët. Kjo është vërtetuar qartë nga shumë filozofë dhe studiues, të cilët hulumtojnë aspekte të ndryshme të planetit tonë. Për shembull, nëse shikojmë horizontin, mund të vërehet se ai është i rrafshët, gjë që drejtpërdrejt dëshmon se Toka nuk është sferë.”*

- Nxënësve u jepen tekste të ndryshme që lidhen me të njëjtën temë, por në to paraqiten aspekte ose këndvështrime të ndryshme. Nxënësit punojnë në grupe të vogla. Secili grup merr një tekst që duhet ta lexojë me kujdes. Më pas duhet të identifikohet ideja kryesore / mesazhi i tekstit. Nxënësit e ndajnë me zë të lartë idenë e tyre kryesore me grupet e tjera. Një nxënës nga çdo grup paraqet përfundimet kryesore nga teksti që kanë lexuar, dhe më pas të gjithë së bashku arrijnë në kuptimin e disa fjalëve dhe shprehjeve për të cilat ka pasur paqartësi në interpretim. P.sh. temat mund të jenë: *Sfidat ekologjike të botës bashkëkohore; Zgjidhjet teknologjike për përballimin e ngrohjes globale; Llojet e aktivizmit për shpëtimin e planetit Tokë; Efektet e ndotjes së ajrit në shëndet etj.*
- Nxënësit punojnë individualisht. Secili nxënës merr një fletë pune që lidhet me një fragment nga leximi i një lektyre. Çdo nxënës ka të drejtë të zgjedhë një nga disa përfundime të ofruara për personazhin kryesor, të cilat janë të shkruara në fletën e punës. Nxënësit duhet të shënojnë shembuj, citate ose detaje të tjera që do të përdoren si prova për të mbështetur përfundimin që kanë zgjedhur. Disa nxënës e prezantojnë punën e tyre para klasës dhe u përgjigjen pyetjeve në lidhje me provat e paraqitura.

**Fusha programore: LETËRSI, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA****Gjithsej: 67 orë****Rezultatet e të nxënit:***Nxënësi/nxënësjë do të jetë i/e aftë:*

1. të përmend rolin e letërsisë popullore shqiptare në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe të krahasojë e të komentojë motivet dhe temat në tregimet e popujve të ndryshëm;
2. të përmend dhe të njoh figurat stilistike të shprehjes: kontrastin, ironinë, pyetjen retorike, antitezën, simbolin në shembuj të dhënë;
3. të dallojë këngët lirike sipas motiveve, duke bërë një vështrim mbi këngët sociale;
4. të paraqes karakteristikat e llojeve liriko-epike përmes shembujve;
5. të shpjegojë dhe interpretojë veprat letrare: tregimin historik, romainn historik, romanin familjar dhe romanin për të rinj në përputhje me përjetimin, kontekstin dhe kuptimin;
6. të dallojë novelën nga veprat e tjera letrare si tregimi dhe romani;
7. të shpjegojë karakteristikat e ligjërimin (diskursin) poetik, prozaik dhe dramatik përmes shembujve dhe të interpretojë bazuar në analizën strukturore dhe stilistike;
8. të identifikojë dhe të analizojë porosinë, elementet stilistike dhe estetike të veprave letrare, duke i lidhur ato me jetën e përditshme;
9. të shprehet me gojë dhe me shkrim duke përdorur argumente për veprat letrare dhe për lekturat;
10. të shkruajë tekste me përdorim praktik dhe tekste ku mund të shprehet për tema të ndryshme;
11. të shkruajë dhe të përgatisë tekste duke respektuar rregullat e strukturës dhe të drejtshkrimit.

*Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon se:*

1. teksti letrar është shumëdimensional dhe ka karakteristikat e veta nga aspekti gjuhësor, përmbajtësor, semantik dhe stilistik, dhe se secili prej tyre kontribuon në vlerën artistike të tekstit;
2. teksti letrar përmban ide të përgjithshme njerëzore që ndikojnë në qëndrimet, mendimet dhe marrëdhëniet ndaj jetës dhe ndaj të tjerëve.

**Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):****Letërsia popullore**

- **Letërsia popullore shqiptare**  
(tregimet popullore: miti, legjenda, përralla, anekdota, fabula, fjalët e urta, gjëgjëza; këngët popullore)
- **Këngë dhe tregime popullore nga popuj të tjerë**  
(llojet e tregimeve, motivet, krahasimi mes tyre)

**Standardet e vlerësimit:**

- Njeh rolin e letërsisë popullore në ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke përmendur shembuj.
- Përmend llojet dhe motivet e tregimeve popullore të popujve të tjerë.
- Krahason llojet dhe motivet e tregimeve popullore të popujve të tjerë me tregimet dhe motivet popullore shqiptare.

<p><b>Lirika</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Lirika sociale</b> (shoqërore)</li> <li>• <b>Llojet liriko-epike</b> (ballada, romanca, poema, elemente epike dhe lirike në veprat liriko-epike, subjekti lirik)</li> <li>• <b>Figurat stilistike të shprehjes</b> (kontrasti, ironia, pyetja retorike, antiteza, simboli)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon këngët lirike sipas motivit, strukturës dhe sipas shprehjes stilistike.</li> <li>• Interpreton vargje nga krijime të ndryshme poetike duke përcaktuar subjektin lirik.</li> <li>• Përcakton motivin dhe subjektin lirik në një poezi sociale.</li> <li>• Analizon dhe interpreton krijime liriko-epike sipas motivit.</li> <li>• Shpjegon dallimet dhe ngjashmëritë midis llojeve liriko-epike të këngëve.</li> <li>• Njeh figurat stilistike të shprehjes në shembuj nga poezitë (kontrastin, ironinë, pyetjen retorike, antitezën, simbolin).</li> <li>• Komenton përjetimin estetik të krijimeve poetike bazuar në përvojën e vet nga veprat e lexuara.</li> </ul>
<p><b>Epika në prozë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Tregimi</b> (tema historike, personazhe historike, personazhe historike të romanizuar (letrarizuar) personalitete historike; leximi i një periudhe të caktuar historike)</li> <li>• <b>Novela</b> (tregim i gjatë, tematika, dallimi mes tregimit e romanit)</li> <li>• <b>Romani</b> (roman për të rinj; roman familjar; roman historik; fabula, motive, tema, ngjarje, rrjedha e ngjarjeve, naratori, personazhet, përshkrimet, porosinë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmend karakteristikat e tregimeve me motive historike të ndryshme (personazhe historike, ngjarje historike, periudha e kaluar).</li> <li>• Dallon novelën nga tregimi dhe nga romani.</li> <li>• Njeh llojet e romaneve sipas temës: historik, familjar, roman për të rinj.</li> <li>• Përmend temat në romanet historike të krijimtarisë letrar shqiptar.</li> <li>• Zbulon dhe diskuton karakteristikat e llojeve të ndryshme të romaneve.</li> <li>• Diskuton dhe arsyeton për personazhet bazuar në pamjen, tiparet, fjalimin, mendimet, reagimet emocionale dhe psikologjike, si dhe për statusin shoqëror në veprën letrare.</li> <li>• Interpreton situata problematike nga teksti duke i lidhur direkt me situata reale nga jeta e përditshme.</li> <li>• Përshkruan kontekstin e një vepre të caktuar letrare.</li> <li>• Interpreton citate të zgjedhura nga një tekst letrar (roman historik, roman familjar, roman për të rinj), të caktuara ose sipas zgjedhjes bazuar në kriteret e dhëna më parë.</li> <li>• Shpjegon me argumente llojin e preferuar letrar nga ato të ka lexuar.</li> <li>• Krahason një tekst letrar dhe përshtatjen e tij në media të tjera (teatër, televizion, film etj.).</li> </ul>
<p><b>Drama</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Tekst dramatik</b> (monodrama, drama bashkëkohore; natyra e dyfishtë e tekstit dramatik; teksti dramatik në raport me shfaqjen teatrale; elemente të shfaqjes teatrale – aktrim, kostumograf, skenograf, regjisor, kompozitor)</li> </ul> <p><b>Filmi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon veçoritë e dramës si një gjini letrare të veçantë dhe mundësinë e saj për t'u vendosur në skenë.</li> <li>• Rendit dallimet midis tekstit dramatik dhe shfaqjes teatrale.</li> <li>• Përmend elementet e shfaqjes teatrale.</li> <li>• Shpjegon konceptin e monodramës përmes shembujve ose fragmenteve nga tekste dramatike.</li> <li>• Interpreton dhe komenton përmbajtjen përmes citateve të zgjedhura nga tekste dramatike bashkëkohore.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Filmi si art</b> (historia e filmit; zhanret; ideja e filmit, sinopsi, skenari; adaptimi filmik i një vepre letrare – skenar filmik bazuar në vepër letrare)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njih dhe shpjegon termat nga fusha e filmit si art: ideja e filmit, sinopsi, (përmbledhje e shkurtër e historisë së filmit – ngjarjet kryesore), skenari.</li> <li>• Jep të dhëna bazë për historinë e filmit.</li> <li>• Përmend zhanret e filmit dhe shpjegon temat që paraqiten në to.</li> <li>• Shpjegon me shembuj se vepra letrare mund të shërbejë si bazë për një skenar filmi.</li> </ul>
<p><b>Llojet letraro-shkencore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Biografia</b> (fakte, informacione të sakta, pasqyrë e qartë, renditje kronologjike e fakteve, përdorimi i stilit shkencor)</li> <li>• <b>Biografia e romanizuar</b> (dallimet midis biografisë dhe biografisë së romanizuar)</li> <li>• <b>Autobiografia</b> (subjektivitet në shkrim; krahasimi midis biografisë dhe autobiografisë)</li> </ul> <p><b>Publicistikë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Udhëpërshkrimi</b> (unë-narrator, rrëfim i bazuar në dëshmi, përshkrime të njerëzve, vendeve dhe zakoneve, përshkrim i përvojave përmes fakteve, mendimeve dhe emocioneve; stil publicistik)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmend karakteristikat e biografisë si një lloj i veçantë letrar-shkencor.</li> <li>• Tregon dallimet midis biografisë dhe biografisë së romanizuar.</li> <li>• Interpret fragment nga një biografi e romanizuar dhe komenton për paraqitjen e fakteve dhe informacioneve në të.</li> <li>• Shpjegon karakteristikat e autobiografisë si një lloj tekstual i veçantë dhe i ndryshëm nga biografia dhe biografia e trilluar e romanizuar.</li> <li>• Analizon një udhëpërshkrimi duke identifikuar karakteristikat e tij.</li> <li>• Përmend format në të cilat mund të paraqitet udhëpërshkrimi (artikull gazetaresk, tekst me fotografi, udhëpërshkrim televiziv/video).</li> <li>• Harton shembuj të rrëfimit të bazuar në dëshmi, duke përshkruar vende, njerëz dhe zakone, dhe përdor përvojën e vet për të paraqitur fakte, mendime dhe emocione.</li> </ul>
<p><b>Tekste për përdorim praktik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Aplikim</b></li> <li>• <b>Ankesë</b></li> <li>• <b>Procesverbal</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon strukturën e teksteve për komunikim praktik-profesional.</li> <li>• Harton aplikime dhe ankesa në kontekste të ndryshme.</li> <li>• Harton procesverbal nga një mbledhje e bashkësisë së klasës.</li> </ul>
<p><b>Të shprehurit dhe krijimtaria</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të shprehurit me shkrim dhe me gojë</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shprehet me shkrim dhe me gojë për përjetimin e një teksti letrar të caktuar.</li> <li>• Shkruan ose flet me argumente për një tekst letrar.</li> <li>• Shpreh me shkrim vlerësimin e vet për një tekst letrar (nga aspekti etik, estetik dhe ideor).</li> </ul>

- **Ese**
- **Prezantim**
- **Të shkuarit kreativ**
- **Vështrim mbi ngjarje kulturore**
- **Të shprehurit me gojë në mënyrë të pavarur mbi një temë të caktuar**

- Shkruan ese me strukturë të qartë, duke shprehur një qëndrim personal të argumentuar.
- Përgatit fjalim me gojë dhe me shkrim mbi tema të ndryshme.
- Përgatit dhe prezanton materiale për tema të ndryshme duke përdorur mjete teknike bashkëkohore për t'u shprehur.
- Shkruan tekst duke shprehur kreativitetin dhe mendimin krijues.
- Shkruan vështrime mbi ngjarje kulturore (për shfaqje teatrale, për vizitë në kinema, për promovim, për ekspozitë).
- Përgatit dhe prezanton në mënyrë të pavarur një fjalim të përshtatshëm për një qëllimin të caktuar.
- Prezanton fjalim duke respektuar rregullat e drejtshqiptimit të gjuhës standarde shqipe.

### Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):

*(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)*

- Nxënësit luajnë lojën: *Kush jam unë?* Secili nxënës tërheq një fletë pune të përgatitur më parë nga mësimdhënësi/-ja, në të cilat jepet një përshkrim i shkurtër i një vepre (p.sh. 1. Disa fleta përmbajnë këto karakteristika: *Jam shumë i/e gjatë – kam disa ngjarje dhe zhvillime – kam shumë personazhe; 2. Jam një ngjarje e shkurtër dhe përqëndrohem në një moment – kam pak personazhe – lexohem shumë shpejt; 3. Nuk jam shumë e gjatë – kam disa personazhe – kam një ngjarje kryesore me më shumë zhvillim*). Ndërkohë, në klasë, në tre vende të ndryshme, janë përcaktuar këndet me mbishkrime: 1. Romani; 2. Novela; 3. Tregimi. Secili nxënës individualisht lexon fletën që ka tërhequr dhe sipas përshkrimit në të, vendoset në këndin që mendon se i përket. (p.sh. nëse ka përshkrimin 1, vendoset te këndi i romanit, nëse ka përshkrimin 2, vendoset te këndi i tregimit dhe nëse ka përshkrimin 3, vendoset te këndi i novelës). Më pas grupet që krijohen sipas përshkrimit, kontrollojnë njëri-tjetrin për të parë nëse secili është vendosur në këndin e duhur.
- Nxënësit në grupe lexojnë përrallën *“Hirushja”* në variante të ndryshme <https://fairytalez.com/sq/blog/cinderella-international-versions/>. Secili grup zgjedh variantin që dëshiron. Ata bëjnë krahasimin e motivit/motiveve në përralla, duke komentuar nga këndvështrime të ndryshme, për rolin e njerks së ligë dhe viktimës së intrigave familjare - personazhit Hirushja. Mësimdhënësi/-ja bën pyetje që lidhen me motivin, por edhe pyetje rreth llojeve të personazheve që paraqiten në të dyja historitë, ngjarjeve që paraqiten, stili në të cilin janë shkruar si dhe objektet magjike që shfaqen në to. I gjithë diskutimi drejtohet drejt përafrimit të karakteristikave të përbashkëta të dy historive, të cilat përmbajnë të njëjtin motiv në variacione të ndryshme. Nxënësit e paraqesin përfundimin përmes një diagrami Veni. (Përrallat, gjithashtu, mund të përdoren dhe të lidhen edhe me tregime bashkëkohore, për të ngritur kështu çështjen e stereotipit të njerks së keqe që përfaqësohet në tekstet folklorike. Shembujt mund të përfshijnë edhe histori me kafshë, fabula dhe tregime realiste).
- Nxënësit ndahen në grupe dhe u jepet një poezi për të cilën mësimdhënësi/-ja ka vendosur qëllime të ndryshme për secilin grup: grupi i parë analizon strukturën e poezisë; grupi i dytë analizon motivin/motivet në poezi; grupi i tretë analizon figurat stilistike që ata njohin në poezi. Pas

prezantimit të punës së bërë, nxënësit marrin një detyrë të re që është e njëjtë për secilin grup - interpretimin e poezisë bazuar në analizë dhe të shkruajnë një përmbledhje me 5-7 fjali, në të cilën ata do të japin edhe një mendim se cili është subjekti lirik në poezi. Edhe kjo detyrë prezantohet gjithashtu para të gjithëve në klasë dhe më pas hapet një diskutim përfundimtar rreth poezisë duke përmbledhur gjithçka që u tha gjatë orës mësimore.

- Nxënësit lexojnë veprën "*Poema e mjerimit*" nga Migjeni. Mësimdhënësi/-ja i ka ndarë vargjet, që do të thotë janë nxjerrë citate për të cilat kërkohet nga nxënësit të thonë një fjalë që mendojnë se është fjalë kyçe për domethënien e citatit. Më pas nxënësit përdorin fjalët kyçe të zgjedhura për të përcaktuar motivin e poemës dhe për të shkruar porosinë nga ajo.
- Nxënësit lexojnë në çifte një baladë ose romancë, secili çift merr një poezi të ndryshme. Ata kanë për detyrë të përcaktojnë elementët lirikë dhe epikë të vargjeve, domethënë të dallojnë pjesët ku shprehen ndjenja dhe mendime nga pjesa narrative (përshkruese) e poezive. Gjithashtu, secili çift duhet të përshkruajë gjendjen shpirtërore të përgjithshme në poezi: e trishtueshme, e lumtur, e këndshme ose e pakëndshme... Secili çift i shpreh argumentet e shkruara dhe të njejtat i përdor si burim diskutimi nga të cilat nxirren elementet e përbashkëta dhe ato që dallojnë mes romancës dhe baladës. Në fund të diskutimit, përcaktohet edhe motivi i poezisë, i cili është i ndryshëm në dy llojet e veprave liriko-epike.
- Nxënësit dëgjojnë poezinë "*Syrgjyn-vdekur*" nga Fan Noli <https://www.youtube.com/watch?v=88lrUU2VINU>. Marrin për detyrë që me disa fjali të shkruajnë përmbajtjen e asaj që dëgjuan dhe të diskutojnë për vargjet në të cilat ndjenë emocion të fortë, duke njohur elementin lirik të poezisë. Pastaj nxënësit marrin poezinë të shkruar në fleta nga mësimdhënësi/-ja dhe diskutojnë vargjet e hijezuara në poezi që përfaqësojnë figurën stilistike të antitezës. Nxënësit shkruajnë strukturën e kësaj figure stilistike pasi mësimdhënësi/-ja e shpjegon atë nëpërmjet shembullit.
- Nxënësit ndjekin një prezantim në të cilin mësimdhënësi/-ja ka vendosur shprehje ironike, ato mund të jenë shembuj nga poezitë ose mund të jenë edhe shprehje të përditshme. Nxënësit komentojnë dhe shpjegojnë çdo thënie dhe në fund sjellin një përfundim se çfarë është ironia, ndërsa mësimdhënësi/-ja shpërndan përkufizimin në bazë të cilit nxënësit pastaj japin shembujt e tyre duke shkruar një tekst të shurtër.
- Nxënësit bëjnë një listë të simboleve që i dinë dhe që kanë njëfarë kuptimi për ta dhe për komunitetin e gjerë në të cilin ndodhen. Më pas mësimdhënësi/-ja i motivon që ata të krijojnë një prozë të shkurtër ose një ligjërim poetik duke përdorur simbolet. Pasi që lexojnë shembujt e përgatitur mësimdhënësi/-ja sqaron se përdorimi i tyre lidhet me figurën stilistike të simbolit, të cilin mësimdhënësi/-ja e vendos në dërrasë.
- Nxënësit luajnë një lojë në të cilën kanë për detyrë të thonë sa më shumë antonime që ju kujtohen. Ata i shkruajnë shembujt në fletore dhe i përdorin ato për të bërë disa shprehje që do të jenë logjikisht të kundërta dhe diskutojnë kuptimin e shprehjeve të tyre. Pastaj mësimdhënësi/ja shpërndan një poezi që përdor kontrastin si figurë stilistike e shprehjes. Në fund të orës së mësimi japin përmbledhjen.
- Mësimdhënësi/ja ka përgatitur një tekst që përmban pyetje në të cilat nuk pritet të ketë përgjigje nga nxënësit. Përveç tekstit të përgatitur në mënyrë të pavarur, mund të përdoret ndonjë monolog i përshtatshëm nga një dramë ose roman, për shembull monologu i famshëm i personazhit Hamlet në dramën me të njëjtin emër nga Shakespiri në të cilin personazhi kryesor i bën vetes pyetjen "*Të jesh apo të mos jesh*". Pasi lexon shembullin nga teksti ose fragmentin nga "*Hamleti*", mësimdhënësi/ja i nxit nxënësit që të analizojnë shprehjet që janë paraqitur në formë të pyetjeve dhe i pyet nxënësit, në çka janë të ngjashme ose të ndryshme ato pyetje të parashtruara nga pyetjet që ai/ajo po ua bën tani drejtpërdrejt atyre. Nxënësit japin përgjigjet e tyre dhe negociojnë bisedën për kuptimin e nocionit *pyetje retorike* që bën mësimdhënësi/ja. Mbas që arrihet një përfundim, ata shkruajnë në fletore si përkujtues, për figurën stilistike të shprehjes, pyetjen retorike.
- Nxënësit kanë për detyrë të zgjedhin një poezi, që për disa arsye, është e veçantë për ta. Në orën e mësimi, ata plotësojnë një fletë pune me kërkesat në vijim: *Më pëlqejnë vargjet: ... dhe më pëlqejnë këto vargje sepse...* (Nga nxënësit pritet të japin përgjigje më komplekse, pra

përgjigje përmes të cilave do të përdorin nocionet që kanë mësuar deri më tani e që lidhen me poezinë, strukturën e saj dhe shprehjet stilistike në poezi).

- Nxënësit shikojnë një pjesë nga filmi artistik shqiptar *"Skënderbeu"*. Pastaj e lexojnë të njëjtën pjesë si fragment nga vepra *"Historia e Skënderbeut"* nga Marin Barleti. Ata diskutojnë për personazhet dhe i krahasojnë ata me figura historike, kryesisht me Skënderbeun dhe diskutojnë pse kjo vepër mund të quhet një rrëfim i cili trajton një kohë të caktuar historike dhe figura historike që luajtën një rol të rëndësishëm në historinë shqiptare. Përfundimet formulohen në formën e një plani. (Me këtë përmbajtje mund të kombinohet edhe me përmbajtje nga të shprehurit dhe krijimtarija ose me përmbajtje nga një film).
- Nxënësit lexojnë fragmente të zgjedhura nga romane me tema të ndryshme. Duke u bazuar në përmbajtjet e tyre, ata komentojnë dhe e përcaktojnë llojin e romanit (roman familjar, roman historik, roman për të rinj). Mund të përdoren titujt që janë pjesë nga lekturat shkollore ose vepra të lexuara, për shembull, një fragment nga vepra *"Kështjella"* e Ismail Kadaresë, *"Harry Potter dhe Guri Filozofal"* nga J.K. Rowling (i përcaktuar si një mister për adoleshentë dhe si një roman fantastik), *"Ditari i Ana Frankut"* nga Ana Frank, *"Dashuria e kapitenit"* nga Resul Shabani, *"Qëndro në qiell"* nga Erin Bou etj. Gjatë diskutimit për temat, nëse nxënësit vetë e kanë lexuar librin, do të jenë në gjendje të vijnë në përfundimin se secili prej romaneve ka një temë dominuese, por edhe tema të tjera që janë plotësuese, që do të thotë se romanet nuk tregojnë gjithmonë një temë.
- Nxënësit lexojnë një fragment të shkurtër nga *"Malësorja"* e Nazmi Rrahmanit. Mësimdhënësi/-ja përgatit informacione rreth rrëfimit dhe e lidh atë me fragmentin në të cilin vërehen marrëdhëniet familjare në këtë vepër. Përmes fragmentit nxënësit nxjerrin përfundim rreth motiveve kryesore në romanet familjare dhe marrëdhëniet në familje nga citatet e përzgjedhura nga mësimdhënësi/-ja.
- Mësimdhënësi/-ja ka përgatitur një listë me romane për të rinj, për shembull: *"Ditari Sekret i Adrian Mole"* nga Sue Townsend, *"Ana nga ferma e gjelbërt"* nga Lusi Mod Montgomery, *"Unë jam Akiko"* nga Stefan Tiqmi, *"Mirëdita, babi"* nga Stjepan Tomash, *"Ndodhi e çuditshme e qenit gjatë natës"* nga Mark Hadon etj., përmes të cilëve i paraqet temat që mund të gjenden në romanet për të rinj. Varësisht nga interesimi i nxënësve, mësimdhënësi/-ja u ofron më shumë informata rreth romaneve dhe jep rekomandime për të lexuar.
- Nxënësit marrin si detyrë që gjatë leximit të lekturës t'u kushtojnë vëmendje të veçantë personazheve, përshkrimeve dhe veprimeve të tyre. Më pas, ata zgjedhin një personazh nga lektura e lexuar dhe bëjnë një prezantim për të, duke përdorur një plan të saktë: Si duket personazhi: (mund të mbështetet me një citat nga libri), pastaj veçojnë dy veprime që janë mishërim i karakterit të tij/saj (që tregojnë se çfarë lloj njeriu është) dhe në fund veçojnë një thënie më të bukur të personazhit dhe e komentojnë atë në kontekstin e gjithë rrëfimit.
- Nxënësit kanë për detyrë të zbulojnë karakteristikën më të rëndësishme të personazhit kryesor nga një lekturë. Për shembull, te *"Plaku dhe deti"* i Heminguejit, ata zgjedhin këmbënguljen si tiparin kryesor të personazhit - Plaku. Më pas, zhvillohet një diskutim mbi rëndësinë e këmbënguljes në detyrat e tyre të përditshme dhe rezultatet që arrijnë kur janë këmbëngulës në diçka. Mësimdhënësi/-ja përpiket që të gjithë në klasë të shprehin mendimin e tyre (për këtë temë, nxënësit mund të përgatisin edhe një fjalim të shkurtër).
- Nxënësit reflektojnë mbi një vepër të lexuar/lekturë, për shembull *"Princi i Vogël"* nga Antoine de Saint-Exupéry dhe i vendosin mesazhet nga udhëtimet e Princit të Vogël në kontekstin e gjërave të rëndësishme dhe të parëndësishme në jetë. Çdo nxënës zgjedh një kapitull, përkatësisht

një ngjarje dhe e shpjegon atë në kontekstin e përditshëm. Për shembull: *është e rëndësishme të kesh lulen tënde (dashurinë) të cilën do ta kultivosh, pavarësisht nëse është më e bukura në botë apo jo.*

- Nxënësit zgjedhin një libër, tregim të shkurtër ose përrallë të preferuar sipas zgjedhjes së tyre dhe përmes argumenteve shpjegojnë pse është e preferuara e tyre (si: tema interesante, një personazh që shërben si shembull dhe model, apo një ngjarje me porosi/mësim).
- Nxënësit rikujtojnë filmin artistik shqiptar dhe fragmentin nga vepra "*Historia e Skënderbeut*" (nga autori shqiptar Marin Barleti) dhe diskutojnë për dallimet dhe ngjashmëritë midis të lexuarit dhe të shikuarit të tij. Më pas, ata shkruajnë një përmbledhje (rezyme) prej 8-10 fjalish të cilën e paraqesin para klasës.
- Nxënësit lexojnë biografinë e një shkencëtari të njohur. Ata identifikojnë karakteristikat kryesore të biografisë: faktet, informacionet e sakta, renditjen kronologjike të paraqitjes së informacioneve dhe pasqyrimin e qartë. Çdo karakteristikë e mbështesin me një citat nga teksti.
- Nxënësit lexojnë biografinë e Migjenit dhe më pas shikojnë një fragment nga dokumentari "*Migjeni*" [https://youtu.be/Qoo0HBodg-I?si=bmdgp\\_7HwL9zy29-](https://youtu.be/Qoo0HBodg-I?si=bmdgp_7HwL9zy29-). Ata krahasojnë karakteristikat e biografive – biografinë me faktografi të qarta, me biografinë e stilizuar/romanizuar (në dokumentar), ku të dhënat jepen në mënyrë interesante dhe emocionuese, si një roman për jetën dhe veprën e Migjenit. Diskutojnë së bashku për dallimet. (Në lidhje me këtë aktivitet mund të shikohet edhe filmi artistik shqiptar "Një natë pa dritë") <https://youtu.be/ZmEYjHZaAqg?si=oCODqSDUh7Nb0so0>)
- Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur fragment nga një autobiografi e vjetër (për shembull, "*Autobiografia*" nga "Fan Noli: *"Lindi nevoja që unë të filloja shkollën në një kohë kur librat ishin të rrallë dhe mësuesit edhe më të rrallë. Mbaj mend se si u nisa drejt Athinës me pak rroba në trastë, por me një vullnet të hekurt për të mësuar gjuhët e huaja dhe historinë. Ishin vite të vështira ku shpesh më mungonte buka, por kurrë nuk më mungonte dëshira për të qenë dikush që do t'i shërbente popullit tim. Çdo faqe libri që lexoja më dukej si një dritare e re që hapej drejt botës. Kujtimet e mia fillojnë me këto rrugëtime të gjata, ku vetmia dhe varfëria ishin shoqet e mia të ngushta, por qëllimi im ishte i madh: të ndriçoja mendjen tim dhe të tjerëve."*) dhe një autobiografi e kohëve të fundit (për shembull, "Lorik" nga Lorik Cana: "*Kur isha fëmijë, topi ishte shoku im më i mirë, por shpejt kuptova se talenti pa punë nuk mjaftonte. Mbaj mend stërvitjet e para nën shi dhe dëborë, kur këmbët më mpiheshin nga i ftohti, por unë nuk ndaloja sepse kisha një ëndërr. Babai im, i cili ishte mentori im i parë, më thoshte gjithmonë: 'Nëse do të bëhesh kampion, duhet të jesh i pari që vjen në fushë dhe i fundit që ikën'. Sot, kur shoh stadiumet plot që thërrasin emrin tim, kuptoj se çdo sakrificë, çdo dietë e rreptë dhe çdo orë stërvitjeje e lodhshme ia ka vlejtur. Suksesi nuk vjen rastësisht; ai vjen nga disiplina e përditshme dhe dashuria për flamurin që mban në zemër."*). Ata diskutojnë sipas pyetjeve të synuara: Kush rrëfen? Çfarë rrëfen për veten e tyre? Çfarë dominon në përshkrimet për vetveten? A është i njohur personi që shkruan autobiografinë? Në cilin gjini letrare janë shkruar këto dy autobiografi? Në çfarë pikash janë të ngjashme? Në çfarë pikash janë të ndryshme? A kanë të njëjtën mënyrë të paraqitjes së fakteve për veten? Nxënësit i shënojnë përgjigjet e tyre dhe i paraqesin ato para klasës.
- Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur një udhëpërshkrim dhe kërkojnë karakteristikat e tij në tekst: *Kush rrëfen? Çfarë rrëfen? Nëse autori ndan ndonjë emocion dhe mendim me lexuesit? Nëse ka mjete vizuale, a ndihmojnë ato në perceptimin e përmbajtjes? Çfarë mendojnë për kulturën e tyre?*). etj. Më pas i shkëmbejnë përgjigjet me njëri-tjetrin dhe i përmbledhin karakteristikat e udhëpërshkrimit së bashku.

- Nxënësit ndjekin një video-udhëpërshkrim (p.sh. Alma Çupi, Blendi Fevziu, Marin Mema etj.) si motivim për të krijuar udhëpërshkrimin e tyre personal. Ata shkruajnë duke pasur parasysh që duhet të kujdesen të përshkruajnë vendet, njerëzit dhe zakonet përmes fakteve, por edhe përmes mendimeve të tyre dhe ndarjes së ndjenjave që u kanë lindur gjatë vizitës. Punimet e përfunduara paraqiten para klasës.
- Nxënësit lexojnë veprën "*14 vjeç dhëndër*" nga Anton Z. Çajupi. Për këtë vepër ata realizojnë një aktivitet projekti: vënien në skenë të një shfaqjeje teatrale në klasë duke u bazuar në tekstin dramatik të lexuar. Përmes këtij aktiviteti, ku do të përfshihen të gjithë nxënësit me role të ndryshme si: aktorë, kostumografë, skenografë, regjisorë, kompozitorë, menaxherë e të tjerë, ata do të mësojnë dallimet midis tekstit dramatik dhe shfaqjes, si dhe elementet që e bëjnë shfaqjen një të tërë. Për një aktivitet të suksesshëm, secili duhet të dijë saktësisht rolin e tij dhe të bashkëpunojë me të tjerët. Aktiviteti mund të ketë një prezantim publik ose vetëm brenda klasës.
- Nxënësit marrin fragmente nga tekste dramatike dhe veçojnë ato në të cilat ka vetëm një personazh që është bartës i veprimit dramatik. Ata i shpjegojnë ato si monodrama dhe komentojnë citatet e veçuara dhe të treguara nga mësimdhënësi/-ja, të cilat i referohen tekstit konkret.
- Nxënësit marrin një detyrë hulumtuese për filmin, të cilën do ta paraqesin përmes një prezantimi përkatës (duke e lidhur me standardin nga fusha të shprehurit dhe krijimtaria që i referohet përmbajtjes së prezantimit). Një pjesë e nxënësve kanë për detyrë të hulumtojnë mbi historinë e filmit, një pjesë mbi zhanret, ndërsa një pjesë tjetër mbi rrugëtimin e idesë filmike përmes sinopsit, skenarit dhe librit të xhirimit. Nga prezantimet që do të dëgjojnë, nxënësit mbajnë shënime informacionet kryesore për temat për të cilat nuk kanë pasur detyrë të hulumtojnë.
- Nxënësit hulumtojnë mbi temën "Letërsia shqiptare në ekranin e filmit". Filmat që gjejnë i prezantojnë duke u bazuar në atë se mbi cilin libër janë shkruar, nëse skenaristi dhe autori i librit janë të njëjtët autorë, nëse ka dhe çfarë lloj dallimesh ka midis dy veprave artistike, si dhe cilat janë mundësitë për ta paraqitur letërsinë si film. Rezultatet e hulumtimit paraqiten (mundet edhe si prezantim) para të gjithëve në klasë.
- Nxënësit diskutojnë për strukturën e teksteve që janë të nevojshme të hartohen në komunikim me institucionet; për shembull, si të bëhet një aplikim për në shkollën e mesme ose si të shkruhet një ankesë kur ka vërejtje, p.sh. për ndonjë konkurs ku kanë marrë pjesë. Strukturat për të cilat diskutojnë paraqiten në tekst. Shkrimet paraqiten para klasës dhe korrigjohen sipas nevojës nga mësimdhënësi/-ja.
- Nxënësit mbajnë procesverbal nga ora e kujdestarisë (bashkësisë së klasës) ku kanë diskutuar mbi temën "Aksioni humanitar" dhe ku janë përcaktuar afatet kohore dhe detyrat për të gjithë nxënësit.
- Nxënësit hartojnë një fjalim për një ngjarjeje aktuale në shkollë ose për një temë që po e mësojnë në një lëndë tjetër. Mësimdhënësi/-ja jep udhëzime për gjatësinë e fjalimit, strukturën dhe prezantimin e tij. Për të të ndjekur suksesin e tyre, nxënësit krijojnë listë kontrolli (check-listë) dhe vetëvlerësohen me pyetjet: A flasim në gjuhën standarde? A përdorim fraza, nocione dhe shprehje të përshtatshme për temën e caktuar? A është i fjalimi i duhur për qëllimin për të cilin është menduar?
- Nxënësit, për një tekst të lexuar në orën e mësimi të gjuhës shqipe, përgatisin një shkrim në të cilin shtjellojnë argumentet e tyre lidhur me elementet etike të paraqitura në tekst ku bëhet prezantimi i vlerave, pastaj mënyrën se si është shkruar teksti pra, gjuha dhe stili i duhur, si dhe për porositë ideore të tekstit. Për punën e realizuar, nxënësit marrin informatë kthyese (feedback).

- Nxënësit shkruajnë një tekst për një vepër letrare të lexuar, duke respektuar rregullat bazë të strukturës së esesë: përzgjedhja e titullit, hyrja në ese përmes pyetjes kyçe për temën e zgjedhur; pjesa kryesore (zhvillimi) – përshkrimi i tezës, detajet, lidhja e fakteve dhe detajeve me idetë; pjesa përmbyllëse – përmbledhja e pikave kryesore, fjalia përmbyllëse që përfundon me një porosi.
- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur – shkruajnë një retrospektivë për një ngjarje kulturore: një shfaqje teatrale, një vizitë në kiema, një promovim libri ose një ekspozitë, sipas zgjedhjes së tyre. Ata shtjellojnë mendimin e tyre përmes fakteve dhe të dhënave të sakta për ngjarjen e vizituar dhe japin komente për të.
- Nxënësit bëjnë një prezantim për një temë që e kanë zgjedhur dhe që mund të lidhet edhe me lëndë të tjera mësimore. Gjatë përgatitjes së prezantimit, ata përdorin gjuhë të përshtatshme, respektojnë rregullat e drejtshkrimit, krijojnë një titull hyrës me informacion të përgjithshëm rreth autorit, një sllajd me burimet e marra rreth informacioneve si dhe një sllajd përmbyllës. Prezantimi përmban sllajde me materiale ilustruese dhe tekst të mjaftueshëm. Prezantimi bëhet para klasës.
- Nxënësit marrin pjesë në një punëtori krijuese për të shkruar mbi një temë të caktuar. Si motivim bazë, mësimdhënësi/-ja ka përgatitur një "mur fjalësh", të cilat nxënësit do t'i përdorin dhe do t'i plotësojnë me fjalorin e tyre aktiv dhe njohuritë që kanë. Si motivim shtesë, mësimdhënësi/-ja ka vënë në dispozicion libra, tregime, romane, ilustrime, fotografi dhe enciklopedi. Nxënësit mund t'i shfletojnë ato për të marrë ide të reja ose për t'u kujtuar për ide që mund t'i realizojnë gjatë shkrimit. Punimet e tyre redaktohen dhe ekspozohen në një hapësirë të përbashkët në klasë.

### **Fusha programore: NJOHURI MEDIATIKE**

**Gjithsej: 10 orë**

#### **Rezultatet e të nxënit:**

*Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:*

1. të vlerësojë vërtetësinë e një përmbajtjeje mediatike të dhënë për shkencën dhe për shëndetin, duke përdorur tregues për zbulimin e dezinformatave;
2. të përcaktojë besueshmërinë e burimeve që lidhen me shkencën dhe për shëndetin, të pranishme në mediat online dhe në rrjetet sociale;
3. të krijojë përmbajtje mediatike nga fusha e shkencës dhe e shëndetit dhe të shpjegojë se si shpërndahen ato me përgjegjësi përmes mediave dhe rrjeteve sociale;
4. të shpjegojë se si funksionojnë algoritmet e rrjeteve sociale.

*Nxënësi /nxënësja do ta zhvillojë:*

1. ndërgjegjësim për pasojat e dëmshme nga përdorimi i informacioneve të paverifikuara që lidhen me shkencën dhe me shëndetin;
2. qasja kritike ndaj përmbajtjeve që i ofrohen në mediat online dhe në rrjetet sociale.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)	Standardet e vlerësimit:
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Dezinformime për shkencën dhe për shëndetin</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rendit indikatorët që tregojnë praninë e dezinformatave në përmbajtjet mediatike për shkencën dhe për shëndetin.</li> <li>• Kontrollon me ndihmën e indikatorëve, nëse përmbajtjet mediatike që lidhen me shkencën dhe me shëndetin përmbajnë dezinformata.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vërtetësia e informacioneve dhe besueshmëria e burimeve që lidhen me shkencën dhe shëndetin, të pranishme në mediat online dhe në rrjetet sociale</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton besueshmërinë e burimit të informacioneve që lidhen me shkencën dhe me shëndetin.</li> <li>• Shpjegon pse prodhuesit e ilaçeve, vitaminave dhe kozmetikës japin informacione të rreme për produktet e tyre.</li> <li>• Rendit pasojat e dëmshme të nënshtrimit ndaj informacioneve të paverifikuara dhe të rreme lidhur me ilaçet, vaksinat dhe bimët mjekësore.</li> <li>• Zbaton vegla të ndryshme online për verifikimin e përmbajtjeve mediatike që lidhen me shkencën dhe me shëndetin.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Krijimi dhe shpërndarja e përmbajtjeve mediatike që lidhen me shkencën dhe shëndetin</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon një burim të besueshëm informacioni për krijimin e një përmbajtjeje mediatike për një temë të dhënë lidhur me shkencën dhe me shëndetin.</li> <li>• Përdor citate dhe të dhëna/prova, si dhe informacione të tjera të vërteta nga burime të besueshme gjatë krijimit të përmbajtjes mediatike për një temë të dhënë lidhur me shkencën dhe me shëndetin.</li> <li>• Shpjegon se çfarë do të thotë shpërndarje e përgjegjshme e informacioneve lidhur me shkencën dhe me shëndetin përmes mediave dhe rrjeteve sociale.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Algoritmet e rrjeteve sociale</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon se si funksionojnë algoritmet e rrjeteve sociale.</li> <li>• Shpjegon se si algoritmet ndjekin zakonet dhe preferencat e përdoruesve dhe u ofrojnë përmbajtje, informacione dhe shërbime të përshtatura.</li> </ul>

### **Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):**

*(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)*

- Nxënësit renditin hapat kryesorë përmes të cilëve mund të verifikohet nëse një postim i caktuar mediatik përmban dezinformata: kush e ka publikuar – a është media relevante, verifikimi i datës së botimit, a ka autor postimi, a ka bashkëbisedues dhe citate, nëse informacioni është marrë nga diku tjetër a është shënuar postimi origjinal, a është krijuar informacioni sipas standardeve gazetareske apo është lajm sensacional, të kërkohet informacioni edhe në media dhe agregatorë të tjerë vendas dhe të huaj, të kontrollohet nëse faqet për verifikimin e fakteve (fact-checking) kanë

botuar tashmë diçka. Më pas, nxënësit të ndarë në grupe të vogla marrin për punë dy përmbajtje të ndryshme mediatike: gjysma e grupeve marrin përmbajtje mediatike që lidhet me shkencën, ndërsa gjysma tjetër përmbajtje që lidhet me shëndetin. Gjatë punës në grupe, çdo grup përdor hapat kryesorë për të verifikuar nëse përmbajtja mediatike është relevante, përkatësisht nëse përmban dezinformata. Pas përfundimit të aktivitetit, çdo grup prezanton punën e realizuar, pas së cilës hapet diskutim.

- Nxënësit punojnë individualisht. Gjysma e nxënësve marrin një informacion të rremë mediatik që trajton një zbulim të caktuar shkencor, ndërsa gjysma tjetër marrin një informacion të rremë mediatik që trajton funksionalitetin shëndetësor të disa barnave, vitaminave dhe produkteve kozmetike. Për të përcaktuar kredibilitetin e burimit të informacionit të dhënë në tekstin me të cilin punojnë, nxënësit ndërmarrin hapat e mëposhtëm: e kërkojnë informacionin përmes Google ose përmes ndonjë motori tjetër kërkimi; Kontrollon nëse edhe mediat e tjera kanë publikim të njëjtë ose të ngjashëm; kontrollojnë nëse faqet për verifikimin e fakteve e kanë analizuar tashmë këtë informacion mediatik; hulumtojnë për të zbuluar cili është qëllimi i këtij publikimi; kontrollojnë nëse në të paraqiten fakte apo mendime; kontrollojnë nëse informacioni është shkruar në përputhje me standardet gazetareske. Pasi ta përfundojnë aktivitetin, secili nxënës, në përputhje me hapat e ndërmarrë kërkimorë, paraqet qëndrimin e vet pse në publik paraqiten informacione të rreme për zbulime të caktuara shkencore dhe produkte shëndetësore.
- Nxënësit, pasi kanë mësuar paraprakisht zbatimin e veglave kryesore për kontrollin dhe verifikimin e përmbajtjeve mediatike, i zbatojnë ato në praktikë mbi përmbajtje mediatike që lidhen me shkencën dhe me shëndetin, ku informacionet janë dhënë në formën e: tekstit, fotografisë ose videos. Pasi përfundojnë me verifikimin e përmbajtjes mediatike, nxënësit renditin, përkatësisht paraqesin qëndrimet e tyre mbi pasojat e dëmshme nga besimi i informacioneve të paverifikuara dhe të rreme lidhur me ilaçet, vaksinat dhe bimët mjekësore, prezantime këto që bazohen në fakte dhe prova konkrete.
- Nxënësit punojnë në çifte. Ata marrin katër informacione mediatike: dy që lidhen me shkencën dhe dy me shëndetin. Nga dy informacionet për shëndetin, vetëm njëra përmban informacione nga një burim i besueshëm; e njëjta situatë është edhe me dy tekstet për shkencën (këtë e di mësimdhënësi/-ja, por jo nxënësit). Detyra e nxënësve është të identifikojnë informacionin që përmban burim të besueshëm, ku të dhënat e paraqitura bazohen në: citate, të dhëna, prova dhe informacione të tjera të vërteta. Për këtë qëllim, nxënësit përdorin mjetin "Për verifikimin e burimeve dhe citateve" dhe gjashtë hapat e "Procesit gazetaresk për verifikimin dhe publikimin e vërtetësisë së citateve dhe burimeve të një informacioni". Pasi çdo çift përfundon aktivitetin, shpjegon se çfarë do të thotë shpërndarje e përgjegjshme e informacioneve lidhur me shkencën dhe me shëndetin përmes mediave dhe rrjeteve sociale, si dhe cilat pasoja mund të lindin nëse shpërndahen informacione të paverifikuara nga burime të pabesueshme.
- Secili nxënës merr detyrë të krijojë një përmbajtje mediatike. Nxënësi zgjedh vetë nëse ajo përmbajtje do të lidhet me shkencën apo me shëndetin. Ata marrin një fletë pune që përmban gjashtë hapa të lidhur me procesin gazetaresk për verifikimin dhe publikimin e një informacioni (1. Verifikimi nga të paktën dy burime; 2. Deklarata nga dëshmitarë okularë ose persona të përfshirë; 3. Bashkëbisedues me emër dhe mbiemër të plotë - përveç rasteve të mbrojtjes së identitetit; 4. Deklarata nga ekspertë ose organizata; 5. Konfirmim ose qëndrim nga burime zyrtare: Qeveria, ministria, institucioni etj., dhe 6. Fotografi/video autentike të ngjarjes ose problematikës). Pasi nxënësit përfundojnë detyrën e punës, ata paraqesin përmbajtjet mediatike para gjithë klasës, pas së cilës hapet diskutim lidhur me besueshmërinë e tyre.

- Nxënësit shpjegojnë me fjalët e tyre nocionin "algoritëm". Vijon detyra që të futen në llogarinë e tyre në *Facebook* përmes telefonit celular ose kompjuterit. Nëse nuk kanë *Facebook*, alternativat më të mira janë *Twitter* ose *Instagram*, ose mund të punojnë së bashku me një nxënës tjetër, nëse kjo është e pranueshme për të dy. Detyra e tyre është të shqyrtojnë murin e tyre të lajmeve (newsfeed) dhe brenda tre minutave të gjejnë përmbajtje që plotëson tre nga këto kriteret:
  - Përmbajtje që lidhet me zonën tuaj lokale (pjesë e qytetit, bashkësia lokale, fshati);
  - Përmbajtje kushtuar ekonomisë;
  - Përmbajtje kushtuar ekologjisë;
  - Përmbajtje që i referohet rajonit të Ballkanit;
  - Përmbajtje që promovon një opsion politik;
  - Përmbajtje që ju bën të qeshni;
  - Përmbajtje që tashmë e keni parë diku (video që keni parë, fakt interesant që tashmë e dini);
  - Përmbajtje e mërziqshme/jointerese, link që nuk do ta hapnit kurrë.

Pasi përfundojnë aktivitetin, hapet një diskutim rreth pyetjeve të mëposhtme: *Çfarë e kishit më të lehtë dhe çfarë më të vështirë për të gjetur? Pse? A ka përmbajtje që nuk arritët t'i gjenit? Nëse po, çfarë mendoni se mund të jetë shkaku për këtë?* Në fund të aktivitetit, nxënësit shpjegojnë se si algoritmet ndjekin zakonet dhe interesat tona, ndërsa të dhënat e mbledhura për ne u mundësojnë kompanive të ndryshme, partive politike dhe formave të tjera të shoqatave t'i drejtojnë më lehtë informacionet dhe reklamat e tyre drejt grupeve të synuara, prej të cilave ndoshta do të kishin përfitimin më të madh. Që të mund të shfrytëzojmë më mirë rrjedhat e informacionit përmes algoritmeve, duhet të hulumtojmë më shumë se cilët janë faktorët kryesorë që e drejtojnë këtë proces. Përndryshe, mund të përballemi me pasojat e paparashikueshme për shkak të vendimeve të automatizuara që përdorin platformat digjitale.

## GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi/mësimdhënësja siguron gjithëpërfshirjen e secilit nxënës në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës së mësimt. Kështu, ai/ajo mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetësues arsimorë, mësues vullnetarë dhe profesionistë të shkollave me qendra burimore). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi/mësimdhënësja trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi/mësimdhënësja përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxisin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi/mësimdhënësja përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlihdin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

## VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet të bëjë vlerësim të përvojave, njohurive dhe aftësive të mëparshme të nxënësve, të ndjekë vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësimi formativ). Për këtë qëllim, mësimdhënësi i përcjell dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- parashtrimin e pyetjeve dhe pjesëmarrjen në diskutime gjatë orës së mësim;
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet në kontrole dijesh (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies;
- pyetjet ese;
- punën me projekte;
- përgatitjen e afisheve;
- ushtrimet kontrolluese;
- testet e njohurive;
- ditarët refleksivë;
- detyrat dhe veprimtaritë hulumtuese gjatë të cilave nxënësi kryen: mbledhjen e të dhënave, evidentimin, paraqitjen e rezultateve - në mënyrë narrative ose me tabela, me diagrame ose me grafikë dhe bën prezantimin e tyre;
- punimet praktike (p.sh. të shkruarit / krijimi i teksteve sipas kërkesave të ndryshme, analiza dhe interpretimet e teksteve letrare, analiza gramatikore e tekstit, demonstrime, skema, ilustrime, prezantime etj.);
- raportet e shkruara me të dhëna nga hulumtimet e kryera.

Pas përfundimit të secilës temë, nxënësi merr (vlerësim sumativ) notë me numër për standardet e arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ kryhet duke kombinuar rezultatin e arritur nga testet e njohurive me notën e progresit të konstatuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr notën sumative (përmbledhëse) me numër.

<b>Fillimi i zbatimit të programit mësimor</b>	Viti shkollor 2027/2028
<b>Institucioni/bartës i programit mësimor</b>	Byroja e Zhvillimit të Arsimit      Биро за развој на образованието
<b>Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19, 229/20, 3/25, 74/25, 250/25 и 111/26) министерката за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот <i>Албанси јазик</i> за IX одделение.</b>	бр. 12-8476/8 26.6.2026 година  Министерка за образование и наука, проф. д-р Весна Јаневска, с.р.  _____